



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	25.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	4469/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.668/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.507/2021 të datës 06.03.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.12/2021 të datës 11.01.2021, të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Komunës së Vushtrrisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.12/2021 e datës 11.01.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpërmjet postës më datë 06.01.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 11.01.2021 dhe është protokolluar më Nr. Port: 77/2021, me pretendimet ankimore për harmonizim të koeficientit nga pesë (5) në gjashtë (6).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.01.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Vushtrrisë. Këshilli më

datë 21.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Vushtrrisë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 10.02.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.12.2021 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, ndërsa kundër këtij vendimi pala, ankuese ka inicuar konflikt administrativ në gjykatën kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative sipas Aktgjykimit A.nr.507/21 të datës 06.03.2023 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar vendimin e Këshillit dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 77/2021 e datës 11.01.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë e datës 15.12.2020 nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë për ankuesin; Njoftim i datës 13.11.2020 nga Udhëheqësi i Personelit për ankuesin; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 22.10.2020 nga ankuesi së bashku me kërkesë për korrigjimin e koeficientit prej 5 në 6; Njoftimin e datës 16.08.2019 nga Udhëheqësi i Personelit për ankuesin; Kërkesë për nivelizim të koeficientit të pagës e datës 24.07.2019; Zarfën e datës 06.01.2021; Akt Emërimit e datës 25.01.2011 të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për Zyrtar i gjendjes civile 1; Listën e pagave shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2020; Shkresa e datës 04.11.2020 nga Kryetari i Komunës për Udhëheqësin e Personelit; Vendimin A/02/363/2017 i datës 18.08.2017 dhe A.nr.766/2018 i datës 26.11.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; dhe përgjigjen në ankesë e datës 21.01.2021 nga Komuna e Vushtrrisë; Aktgjykimit A.nr.507/2021 të datës 06.03.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 25.01.2011 në pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile" në Komunën e Vushtrrisë, më datë 22.10.2020 ka parashtruar kërkesë për korrigjimin e koeficientit prej 5 në 6, tek Kryetari i Komunës së Vushtrrisë. Kryetari i Komunës së Vushtrrisë më datë 04.11.2020 kërkesën e ka përcjell tek Udhëheqësi i Personelit për shqyrtim. Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Vushtrrisë më datë 13.11.2020 ka njoftuar ankuesin lidhur me kërkesën e tij, ndërsa Kryetari i Komunës së Vushtrrisë më datë 15.12.2020 i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij, duke e njoftuar që në momentin kur na mundëson ligji dhe rregulloret ne do t'i inicojmë procedurat.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që të bëhet harmonizimi i koeficientit nga pesë (5) në gjashtë (6) sikurse e kanë nëpunësit në pozita të njëjta kur themelojnë marrëdhënie të re pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e rishqyrtimit të ankesës së ankuesit konstaton se Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil respektivisht neni 7 paragrafi 1 dhe 2 kishte përcaktuar se: “1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat”, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se ngritja e koeficientëve për nëpunësit civil, bëhet nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet dëshmohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa, kështu përderisa nuk ka planifikim buxhetit apo nuk ka kërkesë nga institucioni ku nëpunësi civil është duke e ushtruar pozitën tek institucionet gjegjëse, atëherë nuk mund të ketë ngritje të koeficientit me vendim nga institucioni pa respektuar procedurat, kështoj përderisa nuk plotësohen kushtet e tilla ligjore nëpunësi civil paguhet me pagë siç është përcaktuar në aktin e emërimit me të cilin ka themeluar marrëdhënien e tij të punës, siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 9 paragrafin 1 përcakton se: “Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”, si rrjedhojë autoriteti punëdhënës nuk ka ofruar dëshmi se ka ndërmarr ndonjë veprim konkret që ngritja e koeficienteve të bëhet sipas procedurave ligjore në fuqi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin së më datë 05.02.2023 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ku si rrjedhojë me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave. Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.668/2023, datë 24/05/2023

Avdyl BEKTESHI

Behteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Arben Mehm.
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

